



Shtator 2022

Regjistrohuni tani për Konferencën dhe Ekspozitën e 10-të të Përbashkët Ballkanike – Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme!



Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

[Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimin të Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët Shtator-Nëntor 2022](#)

[Riparimi dhe Rehabilitimi i Sistemit të Kanalizimeve 28-29 Shtator 2022, Tiranë](#)

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Kongresi dhe Ekspozita Botërore e Ujit e IWA, Shtator 2022](#)

Kopenhagen, Danimarkë
11-15 Shtator 2022

[Konferenca dhe ekspozita teknike vjetore e 95-të](#)

UJËRAT NËNTOKËSORË TË BËJMË TË PADUKSHMEN TË DUKSHME

KONFERENCA DHE EKSPOZITA E PËRBASHKËT BALLKANIKE
8-10 NËNTOR 2022
PRISHTINË, KOSOVË



Pas dy vitesh organizimi të konferencave virtuale, SHUKALB dhe SHUKOS kanë kënaqësinë t'ju ftojnë të na bashkoheni **fizikisht** në Konferencën dhe Ekspozitën tonë të 10-të të Përbashkët Ballkanike që do të mbahet më **8-9-10 Nëntor 2022, në Prishtinë, Kosovë**.

Tema e Konferencës **Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme**, është frymëzuar nga Dita Botërore e Ujit 2022, dhe sjell vëmendjen tek rëndësia që ka mbrojtja cilësore dhe sasiore e burimeve tona nëntokësore. Tema është e një rëndësie të veçantë për vendet si Ballkani Perëndimor, të cilët mbështeten shumë në ujërat nëntokësore për nevojat e tyre të furnizimit me ujë. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të re në SHUKALB!

Menaxhimi i Integruar i Aseteve për Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime në Shqipëri – një cikël i

pafund, që do të vazhdojë përtej programit SEEAM



New Orleans, Lousian,
SHBA
8-12 Tetor 2022

Samiti Dixhital i Ujit

Bilbao, Spanjë
29 Nëntor – 2 Dhjetor 2022

Në korrik 2022, SHUKALB finalizoi me sukses zbatimin e projektit 3-vjeçar “Menaxhimit të Aseteve për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime (UK) në Shqipëri”, i cili iu ofrua shoqërive UK në Shqipëri në kuadër të Programit “Shërbimet Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve në Kompanitë e Ujit në Evropën Juglindore (SEEAM)”. Projekti u zbatua nga SHUKALB dhe Hydro-Comp Enterprise si partner teknik, dhe u mbështet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH – GIZ ORF dhe Shoqata Ndërkombëtare e Kompanive Ujësjiellës Kanalizime në Zonën e Mbulimit të Lumit Danub (IAWD).

Përgjatë këtyre 3 viteve të projektit, 21 Shoqëri UK në Shqipëri ka qenë pjesë e programit SEEAM duke pasur mundësinë të njihet me procedurat dhe praktikën e integruara të menaxhimit të asetëve për të përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve dhe për të forcuar performancën e përgjithshme të biznesit të shoqërisë. [lexo më shumë](#)

SHUKALB merr pjesë në trajnimin mbi Zbatimin e Projekteve në kuadër të projektit “Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (RCDN)”



Gjatë datave 29, 30, 31 gusht 2022, në Tiranë, stafi i SHUKALB mori pjesë në një trajnim tre ditor mbi Zbatimin e Projekteve të organizuar në kuadër të Projektit “Rrjeti Rajonal i

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale,

Zhvillimit të Kapaciteteve për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (RCDN)”.

Trajnimi kishte për qëllim trajnimin e Shoqatave të Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime për të mësuar bazat e zbatimit të projekteve dhe për të njohur standardet kryesore të zbatimit të BE-së. [lexo më shumë](#)

Lajme nga anëtarët tanë

Ujësjiellësi Kukës, zyra e kujdesit ndaj klientit e rinovuar sipas standardeve ndërkombëtare



Situata e krijuar si rezultat i pandemisë Covid 19 nxori në pah nevojën emergjente për të optimizuar ndërveprimet dhe përgjigjet midis ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve në sektorin e ujit. Kufizimet e vendosura gjatë pandemisë, theksuan prioritetin e ndërmarrjes së rrugëtimit drejt përmirësimit të shërbimeve publike.

Sistemi i ankesave të klientëve për Ndërmarrjen e Ujësjiellës-kanalizimeve është një mjet efektiv për të përmirësuar qeverisjen e mirë. Pa mekanizma efektivë të ankesave dhe ku mungon ndërgjegjësimi për të drejtat dhe përgjegjësitë, klientët nuk janë në gjendje të adresojnë ankesat e tyre.

Me mbështetjen e Qeverisë Gjermane nëpërmjet GIZ-it, në bashkëpunim me Bashkinë Kukës dhe Ujësjiellësin Kukës, u rinovua tërësisht Qendra e Kujdesit ndaj Konsumatorit. [lexo më shumë](#)

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Korçë ndërmerr fushatën “Përditëso të dhënat e tua”

jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.



“Përditëso të dhënat e tua” përfaqëson një fushatë ndërgjegjësuere të ndërmarrë së fundmi nga Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Korçë (UK Korçë), në vijim të reformës së fiskalizimit të nisur nga Qeveria Shqiptare mbi një vit më parë. Me qëllim shmangien e deklarimeve të pasakta, kjo fushatë vjen si një thirrje drejtuar qytetarëve për të deklaruar të dhënat e tyre, duke lehtësuar në këtë mënyrë urën e bashkëpunimit të vendosur mes shoqërisë dhe klientëve të saj.

Për shumë vite UK Korçë ka në fokus të punës së saj të përditshme përpjekjen maksimale për të qenë Kompania e së Ardhmes dhe ofrues **LIDER** i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri dhe rajon. Një Kompani e së Ardhmes ofron shërbime me cilësi të lartë në një mënyrë shumë efikase duke qenë gjithashtu inovative, gjithëpërfshirëse, e orientuar drejt tregut e konsumatorëve dhe e qëndrueshme. [lexo më shumë](#)

Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Vlorë ndërmerr aksion kundër abuzimeve në rrjetin e ujësjiellës dhe uljen e debitorëve



Thirrja e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Vlorë (UK Vlorë) për të gjithë klientët e saj gjatë muajit gusht është: **STOP Shpërdorimit të Ujit!** Gushti është përgjithësisht një muaj i vështirë për UK Vlorë për shkak të efektit të kombinuar të temperaturave të larta dhe pikut të sezonit turistik që bën që

popullsia në Vlorë të katërfishohet përkohësisht si pasojë e turistëve të shumtë vendas dhe të huaj. Task Forca e UK Vlorë, e drejtuar nga drejtoresha Elona Hodaj, ka ndërmarrë një fushatë për evidentimin e abuzimeve dhe ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e ujësjellësit, ndërsa nga ana tjetër monitoron pagesat nga klientët, për rritjen e arkëtimit dhe uljen e debive. Fushata po zbatohet jo vetëm në qytetin e Vlorës por edhe në Njësitë Administrative. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kursët e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al

Çregjistrohu